



**Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë  
Këshilli për Arsim dhe Aftësim Profesional**

**STANDARDI I PROFESIONIT  
Instruktor/Mësimdhënës për të rritur,  
Niveli5 KKK**

**Spektori: Profesionistët e mësimdhënies**

**Kodi: Profesionistët e trajnimit dhe zhvillimit të stafit — 2424-03<sup>1</sup>**

**KODI sipas klasifikimit të vjetër:  
Profesorët/profesoreshat e teknikës dhe teknologjisë në shkollat e mesme-2325  
ose Profesionistët e tjerë të mësimdhënies të paklasifikuar tjetërkund - 2359.01  
Data e aprovimit:**

---

<sup>11</sup>Megjithatë në librin e klasifikimit të profesioneve nuk ka kod që i përgjigjet këtij profesioni, **shifra 03 i referohet Instruktorit për të rritur.**

**Kystandard është zhvilluar duke u shfrytëzuar si referencë kryesore Standardi i Profesionit i zhvilluar nga Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve të Estonisë (Kutsekoda), “The adult educator, level 5” dhe i përshtatur me formatin dhe kërkesat e Autoritetit Kombëtar të Kualifikimeve të Kosovës.**

**Ekipi i zhvillimit:**

**Koordinator:** Ramë Likaj

**Anëtarë:**

Veton Alihajdari

Edona Nahi

Jetmir Berisha

Berat Lahu

Besart Krasniqi

Binak Morina

Abdurrahman Simnica

Enver Osdautaj

Besart Shala

Majlinda Rizvanolli

**Data e aprovimit ....**

**Valide prej ....**

## **Instruktor/Mësimdhënës për të rritur, niveli 5**

Standardi profesional është një dokument, që përshkruan kërkesat e punës dhe kompetencave profesionale, d.m.th një grup të aftësive, njohurive dhe qëndrimeve të nevojshme për kryerjen e suksesshme të punës.

Fushat e aplikimit të standardit profesional:

- 1) Përgatitjen e kurrikulave dhe programeve të trajnimit në përputhje me kërkesat e tregut të punës;
- 2) Vlerësimin e kompetencës së individëve, duke përfshirë vetë-vlerësimin dhe konformitetin e vlerësimit me rastin e arritjes së këtij kualifikimi;
- 3) Përshkrimin dhe hyrjen në profesion;
- 4) Planifikimin e karrierës dhe krijimi i bazës për të mësuarit gjatë gjithë jetës;
- 5) Përcaktimin e nevojave për trajnim dhe planifikimin e trajnimeve;
- 6) Përgatitjen e përshkrimit të detyrave të punës dhe rekrutimi i punonjësve;
- 7) Krahasimin e profesioneve dhe kualifikimeve.

### **Përshkrimi i punës**

**Instruktori/Mësimdhënësi për të rritur** mbështet të mësuarit dhe vetë-zhvillimin e kandidatëve të rritur në mënyrë të qëllimshme duke krijuar situata të mësuarit, duke i marre parasysh objektivat e vendosura në Kornizën Kombëtare të Kurrikulës dhe Kornizën Bërthamë të Kurrikulës së AAP dhe ti zhvillojë shkathtësitë e veta profesionale sipas mundësive dhe nevojave. **Instruktori/Mësimdhënësi për të rritur** në nivelin 5 është një ofrues trajnimi me përvojë praktike. Ai/ ajo përgatit materialet e nevojshme të trajnimit dhe zhvillon trajnime për një temë të përcaktuar në kurrikulë, duke marrë parasysh se kandidatët e rritur janë individë të ndryshëm në moshë, me përvoja të ndryshme, arsim paraprak dhe status shoqëror të ndryshëm, që kanë tashmë një sistemin bazë të themeluar të dijes, zakonet e të menduarit, paragjykimet, stereotipet, qëndrimet dhe vlerat që i sjellin së bashku në situatën e mësimit.

Kryen trajnime në një fushë të ngushtë.

### **Detyrat të punës**

1. Përgatitja e procesit mësimor/trajnimit
2. Realizimi i procesit mësimor/trajnimit
3. Analiza dhe vlerësimi i procesit mësimor/trajnimit
4. Vetë-zhvillimi profesional

### **Kompetencat bazike të një instruktore/mësimdhënësi për të rritur, niveli i 5 i KKK**

#### **Treguesit e performancës:**

1. Të jetë i familjarizuar me fushën / temën / lëndën e trajnimit.
2. Të jetë i vetëdijshëm për parimet themelore të andragogjisë dhe karakteristikat e veçanta karakteristike të të rriturve. Njeh vlerat e kandidatëve të rritur dhe i merr në konsideratë gjatë ofrimit të trajnimit.
3. Njeh vlerat e kandidatëve të rritur dhe i merr në konsideratë vlerat e rëndësishme etike, ndjek etikën profesionale, respekton Kodin e Etikës.
4. Krijon një mjedis të përshtatshëm që nxit mësimin dhe komunikimin.

5. Përcjellë legjislacionin dhe politikat që rregullojnë të nxënit e të rriturve.
6. E konsideron vetveten si një nxënës, vepron si subjekt i vetë-zhvillimit.
7. Kur jep një trajnim, përdorë gjuhën e pastër amtare, dhe njeh së paku një gjuhë të huaj në nivelin e pranueshëm.
8. Përdorë mjetet e duhura të TIK-ut (teknologjinë e informacionit dhe komunikimit) gjatë përgatitjes, realizimit dhe vlerësimit në procesin e trajnimit, si dhe e di se si të kërkojë informacion nga Web dhe përdor informacion, duke qenë kritik ndaj burimit dhe duke respektuar rregullat e Pronësisë Intelektuale; din për mundësitë e mësimit elektronik dhe e din se si të përdorë metodat e duhura të mësimit elektronik për trajnimin e të rriturve; di si të krijojë, të përdorë dhe të ndajë materialet me bazë në Web; përdor vegla të përshtatshme për të mbështetur vetë-zhvillimin.

#### **Njohuritë:**

- 1) Njeh fushën / temën / lëndën në të cilën ai / ajo ofron trajnimin,
- 2) Identifikon tiparet karakteristike të nxënësit të rritur,
- 3) Aplikon parimet themelore të andragogjisë,
- 4) Zhvillon njohuritë bazë në psikologjinë e komunikimit (kontaktit, vetë-shprehje e qartë, dëgjimin aktiv, këmbëngulësinë),
- 5) Njeh legjislacionin dhe rregulloret që kanë të bëjë me arsimin dhe aftësimin e të rriturve,
- 6) Aplikon parimet e vetë-reflektimit,
- 7) Zbaton Kodin e Etikës.

#### **Metodat e Vlerësimit:**

Kompetencat bazike vlerësohen me një qasje të integruar gjatë trajnimit me kompetencat tjera të përfshira në standardin e profesionit.

#### **Mjedisi i punës dhe aspekte të veçanta të punës**

Orari i punës dhe pushimi i instruktorëve/mësimdhënësve për të rritur është i rregulluar me kontratën e punës. Kushtet e punës mund të rregullohen në mënyrë plotësuëse me anë të masave organizative dhe rregullative të IAAP, bizneseve dhe asociacioneve dhe dokumenteve tjera normative që janë në fuqi. Puna si instruktorë/mësimdhënës për të rritur është e ndryshme dhe sfiduese, kërkon shkathtësi të mira komunikuese dhe menaxhim të mirë të stresit.

Kërkesat për mjedisin fizik të punës për instruktorët/mësimdhënësit për të rritur të rritur varen nga qëllimi dhe/ ose fusha e trajnimit. Kjo do të rregullohet paraprakisht ndërmjet entitetit kontraktues dhe instruktorit/mësimdhënësit.

Mjedisi shoqëror dhe intelektual do të krijohet nga vetë instruktori/ mësimdhënësi gjatë procesit mësimor.

Për profesionin e instruktorit/mësimdhënësit për të rritur janë të rëndësishme shkathtësitë për ruajtje shëndetin mendor dhe fizik, përfshirë zërin.

#### **Mjetet**

Pajisjet e teknologjisë së informacionit dhe komunikimit, mjetet mësimore dhe pajisje të tjera të nevojshme për kryerjen efektive të trajnimeve dhe për aktivitete kreative janë mjetet kryesore të instruktorëve/mësimdhënësve për të rritur. Mjetet do të përdoren duke marrë parasysh tiparet dhe karakteristikat e të mësuarit për të rritur.

### **Karakteristikat personale të nevojshme për këtë punë: aftësitë dhe tiparet e personalitetit**

Aftësitë dhe tiparet e personalitetit të mëposhtëm e mbështesin suksesin e tij për të punuar si instruktor/mësimdhënës për të rritur: aftësia për të mësuar, gatishmëria për bashkëpunim, aftësitë në të shprehur, ndjeshmëria, përkushtimi, menaxhimi i stresit, toleranca, përgjegjësia, aftësisë për të ushtruar vullnetin, përshtatshmëria, kreativiteti, përcaktimi, transparenca dhe aftësia për të menduar në mënyrë kritike.

Vlerat kryesore të instruktorit/mësimdhënësit për të rritur kanë të bëjnë me dinjitetin, integritetin, tolerancën, përgjegjësinë, transparencën dhe një qëndrim se të gjithë individët janë të pajtuar me vlerësimin. Është thelbësore për instruktorin/mësimdhënësin për të rritur që të respektoj kërkesat etike.

### **Arsimi profesional**

**Instruktori/Mësimdhënësipër te rritur** në nivelin e 5 në shumicën e rasteve është një ofrues aftësimi/trajnimi i cili ka një diplomë nga shkollat e larta profesionale ose arsimit të lartë dhe si parakusht duhet të certifikohet me titullin profesional që përmban kompetenca nga andragogjia, pedagogjia dhe didaktika profesionale. Ai/ ajo ka fituar kompetencat profesionale gjatë punës praktike.

### **Titujt e mundshëm zyrtar**

Profesioni i një instruktorit/mësimdhënësi për të rritur nuk nënkupton ekzistencën e një titulli të vetëm zyrtar. Personi në këtë profesion mund të jetë i punësuar në pozita të ndryshme, si një trajner, një mësimdhënës, a ligjërues, instruktor, mentor, konsulent/ këshilltar etj.

### **Dokumentet e nevojshme për punë në fushën profesionale**

Në varësi të fushës në të cilën zhvillohet trajnimi dhe/ ose te subjekti specifik kontraktues, mund të kërkohet nga ofruesi i trajnimeve për të paraqitur dokumente të ndryshme. Për shembull, dokumentet që provojnë që individi është i certifikuar si instruktor/mësimdhënës për të rritur, dokumente që vërtetojnë kompetencat profesionale, etj.

**Profesioni: Instruktori/mësimdhënësipër të rritur niveli i 5 i KKK**

	<b>Funksioni</b>	<b>Përshkrimi i funksionit</b>
1.	Përgatitja e procesit mësimor/trajnimor	<p><b>Aktivitetet kyç:</b> Ky funksion ka të bëjë me:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Përgatit përmbajtjen e një trajnimi/ mësimi të veçantë dhe zgjedhë metodologjinë, duke marrë në konsideratë se rezultatet e mësimi që janë të përcaktuara në kurrikul.</li> <li>2. Përgatit materiale të reja duke ndjekur logjikën e subjektit të trajtimit dhe duke marrë parasysh mundësinë që ofron mjedisi punues. Përdor burimet e duhura dhe bazat standarde.</li> </ol>
2.	Realizimi i procesit mësimor/trajnimor	<p><b>Aktivitetet kyç:</b> Ky funksion ka të bëjë me:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Mbështet kandidatin në përcaktimin e objektivave të tyre mësimore, duke i informuar ata për objektivat që rrjedhin nga programi i trajnimit.</li> <li>2. Krijon ambient të përshtatshëm të nxëniti, duke zbatuar kërkesat e vendosura për mjedisin fizik të mësimi.</li> <li>3. Udhëheq procesin e të mësuarit, duke u siguruar që tema e tij/ saj të paraqitet te nxënësit brenda afatit kohor të caktuar.</li> <li>4. Angazhohet që gjatë realizimit të procesit mësimor/ trajnimit të aplikohet gjithpërfshirja.</li> </ol>
3.	Analiza dhe vlerësimi i procesit mësimor/trajnimor	<p><b>Aktivitetet kyç:</b> Ky funksion ka të bëjë me:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Vlerëson procesin mësimor/ trajnimor, duke ndjekur objektivat e planifikuara.</li> <li>2. Vlerëson rezultatin individual të mësimi të kandidatëve, duke i krahasuar këto me rezultatin e mësimi të caktuar në kurrikulë.</li> <li>3. Reflekton dhe përshkruan aktivitetet e tij/ saj gjatë procesit të trajnimit duke caktuar personalitetin e tij/ saj, sjelljen dhe rezultatet e trajnimit.</li> </ol>
4.	Vetë-zhvillimi profesional	<p><b>Aktivitetet kyç:</b> Ky funksion ka të bëjë me:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Freskon përmbajtjen dhe metodat e trajnimit duke i përditësuar, nëse është e nevojshme.</li> <li>2. Reagon ndaj mbingarkesës së tij/ saj fizike ose mendore duke zvogëluar ngarkesën e punës.</li> <li>3. Zgjeron njohuritë e tij/ saj profesionale në fushën e lëndës/ temës së tij/ saj duke u informuar me tendencat zhvillimeve të fundit.</li> <li>4. Analizon sjelljen dhe rolin e tij/ saj, duke kërkuar zgjidhje në rast të problemeve.</li> </ol>

**Funksioni 1: Përgatitja e procesit mësimor/trajnitimit**

Ky funksion ka të bëjë me përgatitjen e procesit të mësuarit (aktiviteteve të mësimdhënies dhe mësimnxënies) baza e zhvillimit psikofizik të kandidatëve, social e moral.

<b>Aktivitetet kyçe</b>	<b>Kriteret e performancës (Instruktori duhet të jetë në gjendje të):</b>	<b>Njohuritë e nevojshme për të kryer funksionin (Instruktori duhet të ketë njohuri për):</b>	<b>Shkathtësitë (Instruktoriduhet të jetë në gjendje të):</b>	<b>Shkathtësitë kyçe dhe shkathtësitë e shoqëruara me funksionet kyçe</b>
<b>1. Përgatit përmbajtjen e një trajnimi/ mësimi të veçantë dhe zgjedhë, metodologjinë, duke marrë në konsideratë se rezultatet e mësimit janë të përcaktuara në kurrikul.</b>	<ul style="list-style-type: none"><li>- Përcaktoj nivelin që ka të bëjë me fushën profesionale, nivelin e aftësive mësimore dhe motivimin për mësim të një grupi apo edhe të një kandidati dhe e merr atë në konsideratë me rastin e përcaktimit të objektivave për fushën pedagogjike të përgjithshme dhe arsimore, duke u bazuar në programin mësimor;</li><li>- Identifikoj nevojat e veçanta arsimore dhe kërkon përkrahjen e specialistit për ndryshimin e kushteve të mjedisit të nxënës, nëse është e nevojshme;</li></ul>	<ul style="list-style-type: none"><li>- Përshkrimin e nivelit për fushën profesionale, nivelin e aftësive mësimore dhe motivimin për mësim të një grupi apo edhe të një kandidati, dhe e merr atë në konsideratë mbi vendosjen e objektivave për fushën pedagogjike të përgjithshme dhe arsimore, duke u bazuar në programin mësimor;</li><li>- Identifikimin e nevojave të veçanta arsimore dhe kontakton një specialist mbështetës për ndryshimin e kushteve të mjedisit të nxënës, nëse është e nevojshme;</li></ul>	<ul style="list-style-type: none"><li>- Përcaktoj nivelin për fushën profesionale, nivelin e aftësive mësimore dhe motivimin për mësim të një grupi apo edhe të një kandidati, dhe e merr atë në konsideratë mbi vendosjen e objektivave për fushën pedagogjike të përgjithshme dhe arsimore, duke u bazuar në programin mësimor;</li><li>- Përcaktoj nevojat e veçanta arsimore dhe kontakton një specialist mbështetës për ndryshimin e kushteve të mjedisit të nxënës, nëse është e nevojshme;</li></ul>	<ul style="list-style-type: none"><li>- Vet-menaxhimi,</li><li>- Menaxhimi i stresit,</li><li>- Komunikimi,</li><li>- Bashkëpunimi,</li><li>- Iniciativa,</li><li>- Përgjegjësia,</li><li>- Vetëbesimi,</li><li>- Kreativiteti,</li><li>- Toleranca,</li><li>- Të menduarit kritik,</li><li>- Empatia dhe integriteti dhe</li><li>- Qëndrimi pozitiv.</li></ul>
<b>2. Përgatit materiale të reja duke ndjekur logjikën e subjektit të trajtimit dhe duke marrë</b>	<ul style="list-style-type: none"><li>- Hartoj planin e punës së mësimdhënës, duke marrë parasysh kurrikulën dhe planifikon integrimin</li></ul>	<ul style="list-style-type: none"><li>- Përshkrimin e mënyrës së hartimit të planit të punës së mësimdhënës, duke marrë parasysh kurrikulën dhe planifikon</li></ul>	<ul style="list-style-type: none"><li>- Hartoj planin e punës së mësimdhënës, duke marrë parasysh kurrikulën dhe planifikon</li></ul>	

<p><b>parasysh mundësinë që ofron mjedisi punues. Përdor burimet e duhuradhe bazat standarde.</b></p>	<p>ndërdisiplinore në bashkëpunim me kolegët;</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Hartoj planin e njësisë mësimore në bazë të planit të punës;</li> <li>- Përzgjedh metoda të përshtatshme të mësimdhënies dhe të mësimnxënies dhe mënyrës se vlerësimit, duke u mbështetur në objektiva dhe planifikon kohën e aktiviteteve;</li> <li>- Hartoj programin mësimor individual, planin për përkrahje, planin e zhvillimit në bashkëpunim me specialistë të tjerë, nëse është e nevojshme;</li> <li>- Planifikoj procesin e mbështetjes për një kandidat me nevoja të veçanta;</li> <li>- Përdorë literaturë për planifikim te punës.</li> </ul>	<p>integrimin ndërdisiplinore në bashkëpunim me kolegët;</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Përshkrimin emënyrës se hartimit te planit te njësisë mësimore në bazë të planit të punës;</li> <li>- Shpjegimin e metodave të përshtatshme të mësimdhënies dhe mësimnxënies dhe mënyrës se vlerësimit, duke u mbështetur në objektiva dhe planifikon kohën e aktiviteteve;</li> <li>- Shpjegimin e mënyrës se hartimit te programin mësimor individual, planin për përkrahje, planin e zhvillimit në bashkëpunim me specialistë të tjerë, nëse është e nevojshme;</li> <li>- Shpjegimin e mënyrës se planifikimit te procesit per mbështetjen e kandidateve me nevoja të veçanta;</li> <li>- Përshkrimin e burimeve te literaturës për planifikim te punës.</li> </ul>	<p>integrimin ndërdisiplinor në bashkëpunim me kolegët;</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Hartoj planin e njësisë mësimore në bazë të planit të punës;</li> <li>- Përzgjedhë metodat të përshtatshme mësimdhënies dhe të mësimnxënies dhe mënyrës se vlerësimit, duke u mbështetur në objektiva dhe planifikon kohën e aktiviteteve;</li> <li>- Hartoj programin mësimor individual, planin për përkrahje, planin e zhvillimit në bashkëpunim me specialistë të tjerë, nëse është e nevojshme;</li> <li>- Planifikoj procesin ne mbështetje te kandidateve me nevoja të veçanta;</li> <li>- Përdorë literaturë për planifikim te punës.</li> </ul>	
<p><b>3. Gjithpërfshirja</b></p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Përfshijkandidatët, kolegët dhe specialistë ne</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Shpjegimin e mënyrës e përfshirjes se</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Përfshij kandidatët, kolegët dhe specialistët ne</li> </ul>	



	mbështetje në planifikimin e aktiviteteve mësimore; - Informoj palët mbi rezultatet e mësimit, përmbajtjen, organizimin e mësimit, mënyrat e vlerësimit duke përdorur kanale efikase të ndryshme informative (p.sh. mbledhje, e-komunikimit, intervistë individuale).	kandidatëve, kolegëve dhe specialistëve në mbështetje në planifikimin e aktiviteteve mësimore; - Shpjegimin e mënyrës si informon palët mbi rezultatet e mësimit, përmbajtjen, organizimin e mësimit, mënyrat e vlerësimit duke përdorur kanale efikase të ndryshme informative (p.sh. mbledhje, e-komunikimit, intervistë individuale).	mbështetje në planifikimin e aktiviteteve mësimore; - Informimi i palëve mbi rezultatet e mësimit, përmbajtjen, organizimin e mësimit, mënyrat e vlerësimit duke përdorur kanale efikase të ndryshme informative (p.sh. mbledhje, e-komunikimit, intervistë individuale).	
--	--	---	--	--

**Kushtet e realizimit të funksionit:**

**Mjetet e punës dhe mjedisi i punës**

Pajisjet e teknologjisë së informacionit dhe komunikimit, mjetet mësimore dhe pajisje të tjera të nevojshme për kryerjen efektive të trajnimeve dhe për aktivitete kreative janë mjetet kryesore të instruktorëve/mësimdhënësve për të rritur. Mjetet do të përdoren duke marrë parasysh tiparet dhe karakteristikat e të mësuarit për të rritur.

Kushtet e punës mund të rregullohen në mënyrë plotësuese me anë të masave organizative dhe rregullative të IAAP dhe dokumenteve tjera normative që janë në fuqi.

**Kërkesat e vlerësimit:**

Metoda e kombinuar që përmban verifikimin e njohurive teorike si dhe shkathtësive praktike.

Në varësi të vendit ku trajnimi ndodh, dhe/ ose mbi njësinë e veçanta të IAAP të kontraktuar, ofruesit të trajnimit mund të kërkojnë të paraqesin dokumente të ndryshme. Për shembull, dokumente që vërtetojnë kompetencat profesionale, etj.

**Metodat e vlerësimit:**

Dokumentet, portfolio (përfshirë vetë-analizën), intervista e bazuara në dëshmi.

**Funksioni 2: Realizimi i procesit mësimor/trajnim**

Ky funksion ka të bëjë me zhvillimin e ambientit fizik dhe intelektual mësimor dhe ambientin e një kulture organizative të Instruktorit/ mësimdhënësit për të rritur .

Aktivitetet kyçe	Kriteret e performancës (Instruktori duhet të jetë në gjendje të):	Njohuritë e nevojshme për të kryer funksionin (Instruktori duhet të ketë njohuri për):	Shkathtësitë (Instruktori duhet të jetë në gjendje të):	Shkathtësitë kyçe dhe shkathtësitë e shoqëruara me funksionet kyçe
<b>1. Mbështet kandidatin në përcaktimin e objektivave të tyre mësimore, duke i informuar ata për objektivat që rrjedhin nga programi i trajnimit.</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Jep mësim duke u nisur nga personaliteti i kandidatit;</li> <li>- Përcaktoj objektivat dhe integrimin ndërdisiplinor;</li> <li>- Zbatoj metoda të ndryshme dhe ndërmerr aktivitetet rutinore gjatë procesit të mësimdhënies (përcakton p.sh. të njohuritë paraprake, informatat për rezultatet e pritura të mësimit dhe aktivitetet, aktivitetet mësimore për arritjen e objektivave mësimore, mbledhjen e rezultateve të arritura, informatën kthyese);</li> <li>- Analizoj mësimdhënien dhe përshtatë aktivitetet duke u nisur nga nevojat e kandidatit;</li> <li>- Hartoj plane individuale të zhvillimit të kandidateve me ndihmën e specialistëve;</li> <li>- Përdorë mjedisin fizik ekzistues për procesin</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Analizë mësimdhënies dhe përshtatjes së aktiviteteve duke u nisur nga nevojat e kandidatit;</li> <li>- Përshkrimin e mjedisin fizik ekzistues për procesin mësimor, duke u siguruar për sigurinë, duke bërë përshtatjen e tij, duke u nisur nga nevojat e kandidateve, objektivave mësimore dhe kërkesave të mbrojtjes shëndetësore;</li> <li>- Shpjegimin e mënyrave të dhënies se ndihmës se pare në situata të ndryshme.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Jep mësim duke u nisur nga personaliteti i kandidatit,</li> <li>- Përcaktoj objektivat dhe integrimin ndërdisiplinor;</li> <li>- Zbatoj metoda të ndryshme dhe ndërmerr aktivitetet rutinore gjatë procesit të mësimdhënies (përcakton p.sh. të njohuritë paraprake, informatat për rezultatet e pritura të mësimit dhe aktivitetet, aktivitetet mësimore për arritjen e objektivave mësimore, mbledhjen e rezultateve të arritura, informatën kthyese);</li> <li>- Hartoj plane individuale të zhvillimit të</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Vet-menaxhimi,</li> <li>- Menaxhimi i stresit,</li> <li>- Komunikimi,</li> <li>- Bashkëpunimi,</li> <li>- Iniciativa,</li> <li>- Përgjegjësia,</li> <li>- Vetëbesimi,</li> <li>- Kreativiteti,</li> <li>- Toleranca,</li> <li>- Të menduarit kritik,</li> <li>- Eupatia dhe integriteti dhe</li> <li>- Qëndrimi pozitiv.</li> </ul>

	<p>mësimor, duke u siguruar për sigurinë, duke bërë përshtatjen e tij, duke u nisur nga nevojat e kandidateve, objektivave mësimore dhe kërkesave të mbrojtjes shëndetësore;</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Merr pjesë në punën grupore për zhvillimin e procesit mësimor të IAAP;</li> <li>- Kontaktoj personat përgjegjës në rast të problemeve;</li> <li>- Veprojtje në mënyrën më të përshtatshme në rast se kërkohet dhënia e ndihmës së parë.</li> </ul>		<p>kandidateve me ndihmën e specialistëve;</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Përdor mjedisin fizik ekzistues për procesin mësimor, duke u siguruar për sigurinë, duke bërë përshtatjen e tij, duke u nisur nga nevojat e kandidateve, objektivave mësimore dhe kërkesave të mbrojtjes shëndetësore;</li> <li>- Merr pjesë në punën grupore për zhvillimin e mjedisit mësimor të IAAP;</li> <li>- Kontaktoj personat përgjegjës në rast të problemeve;</li> <li>- Veprojtje në mënyrën më të përshtatshme në rast se kërkohet dhënia e ndihmës së parë.</li> </ul>	
<p><b>2. Krijon ambient të përshtatshëm të nxënësve, duke zbatuar kërkesat e vendosura për mjedisin fizik të mësimor.</b></p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Krijon ambient të sigurt, relaksues, bashkëpunues dhe mirëkuptues, që nxit zhvillimin dhe kreativitetin, bazuar në nevojat e kandidatëve, objektivat mësimore dhe duke respektuar të drejtat e njeriut sipas kushtetutës, të drejtat e</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Shpjegimin e dukjes së ambientit të sigurt, relaksues, bashkëpunues dhe mirëkuptues, që nxit zhvillimin dhe kreativitetin, bazuar në nevojat e kandidatëve, objektivat</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Krijon ambient të sigurt, relaksues, bashkëpunues dhe mirëkuptues, që nxit zhvillimin dhe kreativitetin, bazuar në nevojat e kandidatëve, objektivat</li> </ul>	

	<p>kandidatëve por edhe rregullat dhe procedurat e IAAP;</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Zgjidhë problemet e disiplinës, sipas nevojës me përkrahjen e prindërve, kolegëve apo të specialistëve;</li> <li>- Përdorë metoda të përshtatshme të komunikimit për situatën;</li> <li>- Jetë një dëgjues i mirë.</li> </ul>	<p>mësimore dhe duke respektuar të drejtat e njeriut sipas kushtetutës, të drejtat e kandidatëve por edhe rregullat dhe procedurat e IAAP;</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Shpjegimin problemeve të disiplinës, e sipas nevojës duke përfshirë përkrahjen e prindërve, kolegëve apo të specialistëve;</li> <li>- Shpjegimin e metodave të përshtatshme të komunikimit për situatën.</li> </ul>	<p>mësimore dhe duke respektuar të drejtat e njeriut sipas kushtetutës, të drejtat e kandidatëve por edhe rregullat dhe procedurat e IAAP;</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Zgjidhëproblemet e disiplinës, e sipas nevojës me përkrahjen e prindërve, kolegëve apo të specialistëve;</li> <li>- Përdorë metodat e përshtatshme të komunikimit për situatën;</li> <li>- Jetë një dëgjues i mirë.</li> </ul>	
<p><b>3. Udhëheq procesin e të mësuarit, duke u siguruar që tema e tij/ saj të paraqitet te kandidati brenda afatit kohor të caktuar.</b></p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Shpjegoj metodologjinë e hartimit të rregullave për klasën në bashkëpunim me kandidatet dhe mënyrën e zbatimit të tyre në punën e përditshme;</li> <li>- Përgatit rregulla për klasën në bashkëpunim me kandidatet dhe i zbaton ato vazhdimisht në punën e përditshme, gjithashtu ju prezanton këto rregulla të tjerëve.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Shpjegimin e metodologjisë së hartimit të rregullave për klasën në bashkëpunim me kandidatet dhe mënyrën e zbatimit të tyre në punën e përditshme.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Përgatit rregullat për klasën në bashkëpunim me kandidatet dhe i zbaton ato vazhdimisht në punën e përditshme, gjithashtu ju prezanton këto rregulla edhe të tjerëve.</li> </ul>	

**Kushtet e realizimit të funksionit:**

**Mjetet e punës dhe mjedisi i punës:**

Pajisjet e teknologjisë së informacionit dhe komunikimit, mjetet mësimore dhe pajisje të tjera të nevojshme për kryerjen efektive të trajnimeve dhe për aktivitete kreative janë mjetet kryesore të instruktorëve/mësimdhënësve për të rritur. Mjetet do të përdoren duke marrë parasysh tiparet dhe karakteristikat e të mësuarit për të rritur.

Kushtet e punës mund të rregullohen në mënyrë plotësuese me anë të masave organizative dhe rregullative të IAAP dhe dokumenteve tjera normative që janë në fuqi.

**Kërkesat e vlerësimit:**

Metoda e kombinuar që përmban verifikimin e njohurive teorike si dhe shkathtësive praktike.

Në varësi të vendit ku trajnimi ndodh, dhe / ose mbi njësinë e veçanta të IAAP të kontraktuar, ofruesit të trajnimit mund të kërkohet të paraqesin dokumente të ndryshme. Për shembull, dokumente që vërtetojnë kompetencat profesionale, etj.

**Metodat e vlerësimit:**

Dokumentet, portfolio (përfshirë vetë-analizën), intervista e bazuara në dëshmi.

### Funksioni 3: Analiza dhe vlerësimi i procesit mësimor/trajnit

Ky funksion ka të bëjë me analizën e rezultateve të mëimit dhe nevojave për trajnim, vlerësimin e veprimtarive të grupit, hartimin e udhëzimeve për vlerësim duke zgjedhur metodat e duhura për vlerësim dhe përgatitjen e një pasqyre për rezultatet e të nxënësve.

Aktivitetet kyçe	Kriteret e performancës (Instruktori duhet të jetë në gjendje të):	Njohuritë e nevojshme për të kryer funksionin (Instruktori duhet të ketë njohuri për):	Shkathtësitë (Instruktori duhet të jetë në gjendje të):	Shkathtësitë kyçe dhe shkathtësitë e shoqëruara me funksionet kyçe
<p><b>1. Vlerëson procesin mësimor/trajnitin, duke ndjekur objektivat e planifikuara.</b></p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Tregoj instrumentet për vlerësimin e grupit dhe individit gjatë procesit mësimor/trajnitit;</li> <li>- Përshkruaj procedurat e vlerësimit të grupit dhe individit gjatë procesit mësimor/trajnitit;</li> <li>- Vlerësoj veprimtarinë e grupit të trajnimit gjatë zhvillimit të grupeve;</li> <li>- Vlerësoj aspektet e zhvillimit individual të kandidatëve;</li> <li>- Përzgjedh metodat më të përshtatshme për vlerësimin e grupit dhe individit.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Përshkrimin e instrumenteve për vlerësimin e grupit dhe individit;</li> <li>- Përshkrimin e procedurave të vlerësimit të grupit dhe individit;</li> <li>- Vlerësimin e veprimtarisë së grupit të studimit gjatë zhvillimit të grupeve;</li> <li>- Vlerësimin e aspekteve të zhvillimit individual të kandidatëve.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Përzgjedhë metodat më të përshtatshme për vlerësimin e grupit dhe individit.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Vet-menaxhimi,</li> <li>- Menaxhimi i stresit,</li> <li>- Komunikimi,</li> <li>- Bashkëpunimi,</li> <li>- Iniciativa,</li> <li>- Përgjegjësia,</li> <li>- Vetëbesimi,</li> <li>- Kreativiteti,</li> <li>- Toleranca,</li> <li>- Të menduarit kritik,</li> <li>- Empatia dhe integriteti dhe</li> <li>- Qëndrimi pozitiv.</li> </ul>
<p><b>2. Vlerëson rezultatin individual të mëimit të kandidatëve, duke i krahasuar këto me rezultatin e mëimit të caktuar në kurrikulë.</b></p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Përshkruaj metodologjinë e analizës së rezultateve të mëimit dhe të nevojave të tjera të trajnimit;</li> <li>- Analizoj rezultatet e të mëimit dhe të nevojave të tjera të trajnimit;</li> <li>- Përdor metodat e duhura të analizës,</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Përshkrimin e metodologjisë së analizës së rezultateve të mëimit dhe të nevojave të tjera të trajnimit;</li> <li>- Analizën e rezultateve të mëimit dhe të nevojave të tjera të trajnimit;</li> <li>- Hartimin e</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Përdorë metodat e duhura të analizës, dhe duke kërkuar për informacion shtesë për të kuptuar më mirë problemet dhe arsyet e tyre.</li> <li>- Nxjerrë rekomandime</li> </ul>	

	<p>duke kërkuar për informacion shtesë për të kuptuar më mirë problemet dhe arsyet e tyre;</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Hartoj raportin e rezultateve te analizës;</li> <li>- Nxjerr e rekomandimeve nga rezultati i analizës;</li> <li>- Përshkruaj udhëzuesit për vlerësim(formular vlerësimi, udhëzues përmbushje, lista kontrolli) dhe zgjedh metodat e duhura të vlerësimit, duke marrë në konsideratë rezultatet e fundit të kërkimeve shkencore dhe praktikak më të mira;</li> <li>- Hartoj udhëzues për vlerësim(formular vlerësimi, udhëzues përmbushje lista kontrolli) dhe zgjedh metodat e duhura të vlerësimit, duke marrë në konsideratë rezultatet e fundit të kërkimeve shkencore dhe praktikak më të mira.</li> </ul>	<p>raportit te rezultateve te analizës;</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Përshkrimin e udhëzuesve për vlerësim (formular vlerësimi, udhëzues përmbushje, lista kontrolli) dhe zgjedh metodat e duhura të vlerësimit, duke marrë në konsideratë të fundit rezultatet e fundit të kërkimeveshkencore dhe praktikak më të mira;</li> <li>- Hartimin e udhëzuesve për vlerësim(formular vlerësimi, udhëzues përmbushje, lista kontrolli) dhe zgjedh metodat e duhura të vlerësimit, duke marrë në konsideratë rezultatet e fundit të kërkimeve shkencore dhe praktikak më të mira.</li> </ul>	<p>nga rezultatet e analizës.</p>	
<p><b>3. Reflekton dhe përshkruan aktivitetet e tij/ saj gjatë procesit të</b></p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Reflektoj mbi aktivitetet e tij/ saj, gjate proceseve te mësuarit ne grup;</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Vlerësimin e aktiviteve te tij/ saj (kandidatit);</li> <li>- Planifikimin e</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Reflektoj për aktivitetet e tij/saj, gjate proceseve te të</li> </ul>	

<p><b>trajnimin duke caktuar personalitetin e tij/ saj, sjelljen dhe rezultatet e trajnimit.</b></p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Reflektoj mbi aktivitetet gjate proceseve individuale të zhvillimit;</li> <li>- Vlerësoj aktivitetet e tij/ saj (kandidatit);</li> <li>- Përcaktoj nevojat për vetë-zhvillim;</li> <li>- Planifikoj aktivitetet për të realizuar zhvillimin;</li> <li>- Përdorë mjete për vetë-analizë;</li> <li>- Analizoj rezultatit e të mësuarit dhe mendimet e marra;</li> <li>- Shpjegoj instrumentet për paraqitjen e rezultatet e te nxënit;</li> <li>- Hartoj instrumente për paraqitjen e rezultateve te të nxënit;</li> <li>- Përgatit një pasqyrë të rezultateve të të nxënit (vlerësimit, veprimet e mëtejshme, etj relevante);</li> <li>- Njoftoj palët e interesuara në lidhje me rezultatet e te nxënit;</li> <li>- Përzgjedh vetë për vete/ metodat për njoftimin.</li> </ul>	<p>aktiviteteve për të realizuar zhvillimin;</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Analizën e rezultateve të mësuarit dhe mendimet e marra;</li> <li>- Shpjegimin e instrumentet për paraqitjen e rezultatet e të nxënit;</li> <li>- Planifikimin aktivitetet për të realizuar zhvillimin.</li> </ul>	<p>mësuarit ne grup;</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Reflektojpër aktivitetet gjate proceseve individuale të zhvillimit;</li> <li>- Përcaktoj nevojat për vetë-zhvillim;</li> <li>- Përdorë mjete për vetë-analizë;</li> <li>- Analizoj rezultatit e të mësuarit dhe mendimet e marra;</li> <li>- Përgatitë një pasqyrë të rezultateve të nxënit (vlerësimit, veprimet e mëtejshme, etj relevante);</li> <li>- Njoftoj palët e interesuara në lidhje me rezultatet e te nxënit;</li> <li>- Përzgjedhë vetë metodat për njoftim.</li> </ul>	
--	---	--	---	--

**Kushtet e realizimit të funksionit:**  
**Mjetet e punës dhe mjedisi i punës**

Pajisjet e teknologjisë së informacionit dhe komunikimit, mjetet mësimore dhe pajisje të tjera të nevojshme për kryerjen efektive të trajnimeve dhe për aktivitete kreative janë mjetet kryesore të



instrukturëve/mësimdhënësve për të rritur. Mjetet do të përdoren duke marrë parasysh tiparet dhe karakteristikat e të mësuarit për të rritur.

Kushtet e punës mund të rregullohen në mënyrë plotësuese me anë të masave organizative dhe rregullative të IAAP dhe dokumenteve tjera normative që janë në fuqi.

**Kërkesat e vlerësimit:**

Metoda e kombinuar që përmban verifikimin e njohurive teorike si dhe shkathtësive praktike.

Në varësi të vendit ku trajnimi ndodh, dhe/ ose mbi njësinë e veçanta të IAAP të kontraktuara, ofruesit të trajnimit mund të kërkojnë të paraqesin dokumente të ndryshme. Për shembull, dokumente që vërtetojnë kompetencat profesionale, etj.

**Metodat e vlerësimit:**

Dokumentet, portfolio (përfshirë vetë-analizën), intervista e bazuara në dëshmi.

DRAFT

#### Funksioni 4: Vetë-zhvillimi profesional

Ky funksion ka të bëjë me ripërtëritjen e metodave dhe përmbajtjes së mësimdhënies duke përcjellur zhvillimet në fushën e tij/saj profesionale. Poashtu angazhimin në vetë-reflektim, duke marrë në konsideratë gjendjen e tij/ saj fizike, intelektuale dhe emocionale, si dhe marrjen e masave për të arritur dhe për të ruajtur ekuilibrin.

Aktivitetet kyçe	Kriteret e performancës (Instruktori duhet të jetë në gjendje të):	Njohuritë e nevojshme për të kryer funksionin (Instruktori duhet të ketë njohuri për):	Shkathtësitë (Instruktori duhet të jetë në gjendje të):	Shkathtësitë kyçe dhe shkathtësitë e shoqëruara me funksionet kyçe
<b>1. Freskon përmbajtjen dhe metodat e trajnimit duke i përditësuar, nëse është e nevojshme.</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Shpjegoj nevojat për freskimin e metodave të mësimdhënies, nëse është e nevojshme;</li> <li>- Ripërtërijë metodat e mësimdhënies dhe, nëse është e nevojshme;</li> <li>- Përditësoj përmbajtjen e mësimdhënies, duke ndjekur zhvillimet në fushën e tij/ saj profesionale, dhe literaturën e re profesionale.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Shpjegimin e nevojës për freskimin e metodave të mësimdhënies dhe, nëse është e nevojshme.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Ripërtërijmeto dat e mësimdhënies nëse është e nevojshme;</li> <li>- Përditësoj përmbajtjen e mësimdhënies, duke ndjekur zhvillimet në fushën e tij/ saj profesionale, dhe literaturën e re profesionale.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Vet-menaxhimi,</li> <li>- Menaxhimi i stresit,</li> <li>- Komunikimi,</li> <li>- Bashkëpunimi,</li> <li>- Iniciativa,</li> <li>- Përgjegjësia,</li> <li>- Vetëbesimi,</li> <li>- Kreativiteti,</li> <li>- Toleranca,</li> <li>- Të menduarit kritik,</li> <li>- Empatia dhe integriteti dhe</li> <li>- Qëndrimi pozitiv.</li> </ul>
<b>2. Reagon ndaj mbingarkesës së tij/ saj fizike ose mendore duke zvogëluar ngarkesën e punës.</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Përshkruaj mënyrat e vetë-reflektimit;</li> <li>- Angazhohet në vetë-reflektim;</li> <li>- Merr në konsideratë gjendjen e tij/ saj fizike, intelektuale dhe emocionale;</li> <li>- Merr masa për të arritur dhe për të ruajtur ekuilibrin.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Përshkrimin e mënyrave të vetë-reflektimit.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Angazhohet në vetë-reflektim;</li> <li>- Merr në konsideratë gjendjen e tij/ saj fizike, intelektuale dhe emocionale;</li> <li>- Merr masa për të arritur dhe për të ruajtur ekuilibrin.</li> </ul>	

<b>3. Zgjeron njohuritë e tij/ saj profesionale në fushën e lëndës/ temës së tij/ saj duke u informuar me tendencate zhvillimeve të fundit.</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Përshkruaj trendët më të reja në fushën e tij profesionale;</li> <li>- Zgjeroj njohuritë e tij/ saj në fushën e andragogjisë;</li> <li>- Merr kompetencat konform me nivelin 5 të një mësimdhënësi për të rritur.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Përshkrimin etrendëve më të reja në fushën e tij profesionale.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Zgjeroj njohuritë e tij / saj në fushën e andragogjisë;</li> <li>- Zbatoj kompetencat konform në nivelin 5 të një mësimdhënësi për të rritur.</li> </ul>	
<b>4. Analizon sjelljen dhe rolin e tij/ saj, duke kërkuar zgjidhje në rast të problemeve.</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Përshkruaj aftësitë dhe tiparet e personalitetit të nevojshme për punën e suksesshme;</li> <li>- Zhvilloj aftësitë dhe tiparet e personalitetit të nevojshme për punën e suksesshme, vlerat e vetëzhvillimit te përhershëm.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Përshkrimin e aftësive dhe tipareve të personalitetit të nevojshme për punën e suksesshme.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Zhvilloj shkathtësitë dhe tiparet e personalitetit të nevojshme për punën e suksesshme, vlerat e vetëzhvillimit te përhershëm.</li> </ul>	

#### **Kushtet e realizimit të funksionit:**

##### **Mjetet e punës dhe mjedisi i punës**

Pajisjet e teknologjisë së informacionit dhe komunikimit, mjetet mësimore dhe pajisje të tjera të nevojshme për kryerjen efektive të trajnimeve dhe për aktivitete kreative janë mjetet kryesore të instruktorëve/mësimdhënësve për të rritur. Mjetet do të përdoren duke marrë parasysh tiparet dhe karakteristikat e të mësuarit për të rritur.

Kushtet e punës mund të rregullohen në mënyrë plotësuese me ane të masave organizative dhe rregullative të IAAP dhe dokumenteve tjera normative që janë në fuqi.

#### **Kërkesat e vlerësimit:**

Metoda e kombinuar që përmban verifikimin e njohurive teorike si dhe shkathtësive praktike.

Në varësi të vendit ku trajnimi ndodh, dhe / ose mbi njësinë e veçanta të IAAP të kontraktuar, ofruesit e trajnimit mund të kërkojnë të paraqesin dokumente të ndryshme. Për shembull, dokumente që vërtetojnë kompetencat profesionale, etj.

#### **Metodat e vlerësimit:**

Dokumentet, portfolio (përfshirë vetë-analizën), intervista e bazuara në dëshmi.